



## **Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

### **Nr. 24**

Datë: 02. 06. 2017, ora: 12:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Ercan Spat, anëtar i KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Nenad Rikallo, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

---

## **RENDI I DITËS**

1. Hyrje: z. Ercan Spat, anëtar i KQZ-së

2. Aktivitetet e ZRPP-së

Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve grupi i pestë

3. Raport i Këshillave të KQZ-së

• Këshilli për Operacione Zgjedhore

- Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së KVV-ve në Zubin Potok për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, 2017

4. Të ndryshme

---

## **1. Hyrje: z. Ercan Spat, kryesues i mbledhjes së KOZ-së**

**Ercan Spat:** Po e fillojmë mbledhjen e 24 me radhë të KQZ-së. Fillimisht, po ju informojë se me autorizimin e kryetares së KQZ-së sipas rregullores së punës së KQZ-së do të mundohemi ta kryesoj mbledhjen e sodit me konstatimin se, janë prezentë tetë (8) anëtarë të KQZ-së. Dhe po vazhdojmë. E kemi propozimin e rendit të ditës prej Sekretariatit të cilin, e kemi marrë paraprakisht...A ka dikush diçka të deklarojë, të jap prirje apo sugjerime në rendin e ditës...? Nëse jo, kush është për këtë renditje ?

Konstatoj se me vota anonime, pra me tetë vota, aprovohet rendi i ditës. Dhe, vazhdojmë me aktivitetet e ZRPP-së. E kemi rekomandime për akreditimin e vëzhguesve të grupit të pestë (5).

## **2. Aktivitetet e ZRPP-së**

*Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve grupi i pestë*

**Miradije Mavriqi,** drejtoreshë e ZRPP, tha se zyra ka procesuar deri më tani listat e 1 organizate ndërkombëtare dhe 4 organizatave jo qeveritare vendore, të 6 mediave, dhe të 2 ambasadave ndërkombëtare, me gjithsej 130 vëzhgues. Ju njoftojë, tha znj. Mavriqi se, janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara sipas nenit 54 dhe 55 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të nenit 3 të Rregullës Zgjedhore 07/2013 “Vëzhguesit e zgjedhjeve”. Zyra rekomandon që të akreditohen këta vëzhgues. Listat e këtyre vëzhguesve, i keni të bashkangjitur si edhe emrat e gjithë këtyre organizatave të vëzhguesve.

**Ercan Spat:** A ka dikush diçka lidhur me propozimin e Zyrës të Regjistrimit të Partive Politike...? Nëse jo, a mundemi me e hedhë në votim: akreditimin e 130 vëzhguesve prej 13 organizata vendore dhe ndërkombëtare...?

*Anëtarët e KQZ-së, me 9 vota për, aprovuan rekomandimin e këtyre vëzhguesve*

## **3. Raport i Këshillave të KOZ-së**

*Këshilli për Operacione Zgjedhore*

*- Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së KVV-ve në Zubin Potok për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, 2017*

**Ercan Spat:** Kryesues, s’besoj që keni me shtuar diçka, diskutuam edhe dje, dhe i kemi shtjerrë diskutimet...!

**Adnan Rrustemi:** Jo, jo...

**Ercan Spat:** Ndërsa tani kemi para vetës dy opsione: e keni të gjithë versionin e vjetër dhe versionin e fundit...! A ka nevojë Sekretariati për ndonjë informatë shtesë me na ofruar? Urdhëroni...?

**Nexhmedin Hyseni:** Faleminderit kryesues të nderuar, anëtarë dhe të pranishëm. Pasi në ditën e djeshme në mbledhjen e Komisionit Qendror Zgjedhorë, është kthyer lista e përbërjes së Këshillave të Vendotimit për Komunën e Zubin Potokut, menjëherë kemi kërkuar nga kryesuesja e KKZ-së që në këtë rast edhe KKZ-ja komplet të bëjë ndryshimet sipas kërkesave të Komisionit Qendror Zgjedhorë. Në vërejtjet që janë dhënë, KKZ-ja e ka dërguar listën me përmirësimet e bëra. Do të ju njoftoj nga njëra listë që e keni përpara. Është versioni i vjetër që ka qenë përpara, që ka qenë i prezantuar dje në mbledhje. Ndërsa lista e re, ka ardhur sot nga komuna e Zubin Potokut. Ndryshimet i keni, tha z. Hyseni sepse, në mbledhjen e djeshme nominimet e subjektit politik SLS nuk ka pasur. Por tashmë e kemi me 7 anëtarë: 2 kryesues, 3 anëtarë dhe 2 rezervë. Në anën tjetër, te GISL-ja (numër rendor 3), i ka pasur 5 kryesues, 10 anëtarë, ndërsa tashmë e kemi ndryshe 7 kryesues, 8 anëtarë dhe rezervë. Te alternativa, kjo GI EREMENDJE, ka pasur kryesues ditën e djeshme, ndërsa sot nuk ka asnjë kryesues. Dje ka pasur 9 anëtarë, ndërsa i ka 6. Partia Gorane, dje e ka pasur 1 kryesues, ndërsa sot nuk e ka asnjë, dhe 10 anëtarë, ndërsa sot i ka 6. PDS-i i ka pasur 3 kryesues, ndërsa në listën e re i ka 5 kryesues: 5 anëtarë dhe aq nominime ka pasur, aq janë edhe në listë...

Këto janë ndryshimet e bëra nga dita e djeshme. Dhe, para se me filluar mbledhja e kemi edhe një konfirmim përmes telefonit se, edhe partia PKS ka nominime, dhe ne kemi udhëzuar që nëse kanë nominime të i drejtohen KKZ-së, e njëkohësisht, të njëjtën listë ta bartë edhe në Sekretariat, që nëse i plotësojnë edhe ata kriteret t'i futin në këtë listë sepse, përbërja e këshillave të vendotimeve është me 5 anëtarë, e në disa raste, me 6. Me përmbylljen e kësaj, në të gjitha KKV-të përbërjet janë verifikuar. Kemi marrë edhe rezultatet nga shërbimi votues. Tashmë, jemi duke i pritur edhe rezultatet nga PZAP - i dhe Prokuroria. Dhe, të gjithë ata të cilët nuk i plotësojnë kriteret ligjore, të jenë apo edhe janë të komunave tjera përkatëse. Do të kërkohet nga KKZ-ja, respektivisht nga subjektet politike të bëjnë zëvendësimin e tyre, ndërsa ju do t'i keni edhe me e-mail me të gjitha të dhënat e këtyre komisionarëve. Po ashtu, edhe në CD-në veç e veç, secili...

**Ercan Spat:** Mirë zotëri Hyseni. A keni ndonjë gjë në lidhje me çështjen? Urdhëroni zotëri Gjoshi.

**Betim Gjoshi:** Unë mendoj se, kjo e sodit ofron gjithë përfshirje, eventualisht nëse vjen edhe një subjekt i ri, e që është i certifikuar për zgjedhje. Atëherë, do ta shtonte vlerën, por nuk duhet të ketë më shumë se një anëtarë në vendotim: maksimalja 13. Unë mendoj se, jemi më afër gjithë përfshirjes me këtë se sa që kemi qenë deri dje. Unë, e përkrahi..., do të thotë mendoj edhe me i

dhënë atë hapësirë, dhe pastaj me na u sjellë lista edhe neve, edhe krejt listat në të gjithë Kosovën, nëse ka...

**Ercan Spat:** Faleminderit zotëri Gjoshi. Atëherë a mundemi me konstatimin se janë bërë përmirësimet e duhura në drejtim të kërkesës së KQZ-së prej dje, të hedhim në votim këtë propozim, gjithnjë me këtë sqarim të fundit se, kemi mundësi të rritjes së numrit, pasi që ekziston hapësira edhe nevoja për rritje. Kush është për...?

Konstatohet se, me vota unanime, kërkohet falje me 8 vota dhe 1 abstenim (Adnan Rrustemi) miratohet.

**Adnan Rrustemi:** Një pyetje kam për Sekretariatit: A kemi ndonjë listë në dispozicion të Komisionarëve të dënuar në proceset e mëparshme për arsye elektorale, jo për dënime tjera...?

**Nexhmedin Hyseni:** Kam marrë sot konfirmimin në orët e hershme të mëngjesit nga kryesuesi i PZAP-s se sot, do të na e sjellin listën e të gjithë atyre që eventualisht e kanë të ndaluar. Jemi duke e pritur konfirmimin që pastaj, t'iu shërbejmë edhe juve me të gjitha të dhënat e komisionarëve të konfirmuar.

**Betim Gjoshi:** Rregullorja e kërkon më gjerësisht se PZAP-i, veç shikoni, d.m.th në bazë të rregullës bëni verifikimin e tyre...

**Enis Halimi:** Ne e kemi edhe data bazën tonë dhe se krejt vendimet që vijnë, që janë përfundimtare por edhe të shkallës së parë, d.m.th, e kemi mbajtur një data bazë tonën sepse, edhe ne jemi palë që kemi paditë, kështu që i kemi ato...

**Adnan Rrustemi:** Ne mos gaboj, ka qenë një praktikë në zgjedhjet e kaluara, jo vetëm ata që kanë qenë me vendim të formës së prerë, jo por edhe ata që janë akuzuar për keqpërdorime të zgjedhjeve më nuk mund të jenë...

**Ercan Spat:** Ju faleminderit për diskutimet e vlefshme. A kemi diçka në pika të ndryshme, e di se disa kanë me udhëtuar janë të padurueshëm kolegët.

**Betim Gjoshi:** Kryeshef, a kemi sot mbledhje, a kemi ndonjë arsye me pas mbledhje?

**Enis Halimi:** Këshillat e Vendvotimeve veç u emëruan...!

**Betim Gjoshi:** E kemi bërë si kërkesë që dy ditë radhazi një çështje që, është diskutuar sepse, ma nuk ka kuptim me e diskutuar pas trajnimit dhe me u bo ajo punë...Po dua të them, me e gjetur një metodë se qysh me e krijuar mbrojtjen e votës së partive dhe të kandidatëve për deputet, një numërim më të saktë me një fjalë...

**Adnan Rrustemi:** Me forcuar numërimi, jo jashtë ligjit por me theksuar këtë...!

**Eshref Vishi:** Kryeshef, unë mendoj që absolutisht kjo nuk ka të bëjë me çështje administrative, ka të bëjë me çështje teknike në vendvotim, tek procesi i numërimit, këtu duhet të forcohet a po kupton..? Hiq më tepër, d.m.th janë disa elemente teknike që duhet të bëhen në mënyrë që të bëhet kjo...

#### **4. Të ndryshme**

Për KQZ

Ercan Spat, anëtar i KQZ-së

-----